



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 271, Datë 21.12.2018**

**MBI**

**NDRYSHIMIN E AFATEVE TË RREGULLORES PËR “KRITERET STANDARTE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 181, DATË 10.11.2017**

Në mbështetje të nenit 7 pika 1 dhe nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 104, pika 4,; nenit 113, pika 1 dhe 3 e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”; nenit 26 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike “Mbi ndryshimin e afateve të rregullores për “Kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 181, datë 10.11.2017

**Konstatoi se:**

- Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017 Bordi i ERE-s vendosi: miratimin e rregullores për “Kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”
- OSHEE sha në shkresën me Nr. 16891/1Prot, datë 28.09.2018, protokolluar me tonën Nr. 575/1 Prot, datë 01.11.2018 lidhur me implementimin e rregullores për “Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”, ka kërkuar shtyrjen e afateve të përcaktuar në këtë rregullore, duke kërkuar një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarte të performances në zona të ndryshme.
- Për të sqaruar më tepër problematiken e cituar nga “OSHEE”sha, dhe argumentat e sjella në funksion të kërkesës së tyre për shtyrjen e afateve, ERE në shkresën e saj me Nr. 729 Prot, datë 15.11. 2018 ka njoftuar organizimin e një seance dëgjimore lidhur me diskutimin e të gjitha problematikave për të cilat kompania “OSHEE”sha, kërkon shtyrjen e afateve të përcaktura në rregulloren “Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”
- Gjate diskutimeve ne seance rezultoi se :

- Ka problematika në rrjetin e sistemit të shpërndarjes dhe mungesa të sistemit të matjes SMART, të cilat janë prioritet në zonat që kanë peshë specifike më të madhe për konsumin e energjisë elektrike
- Si rezultat i sa më sipër “OSHEE” sha, thekson se është e paaftë për të përmbushur detyrimet sipas standarteve të shprehura në rregulloren e miratuar nga ERE me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017 dhe në këto kushte kërkon nga ERE rishikimin e rregullores duke u shprehur për një aplikim të përshkallëzuar, për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarte të performancës në zona si me poshte:
  - Zona: Tirane –Durrres, afatati i kerkuar – brenda dates 31.12.2020
  - Zona: Vlore- Elbasa- Fier, afati i kerkuar - brenda dates 31.12.2021
  - Zona: Gjirokastrer - Berat - Korççe, afati i kerkuar - brenda dates 31.12.2022
  - Zona: Shkoder - Burel - Kukes, afati i kerkuar - brenda dates 31.12.2013

Drejtoritë Teknike të ERE duke shqyrtuar sa më sipër cituar nga kompania “OSHEE”sha, dhe duke evidentuar pamundësinë e realizimit të investimeve të domosdoshme e gjykon të arsyeshme shtyrjen e afateve për realizimin e parametrave të kerkuar nga “*Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike*”, për një periudhë 6-mujore me kushtin që : brenda kësaj periudhe kompania të dorëzojë në ERE nje studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara.

- Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 798/1 prot., datë 19.12.2018, ka përcjelle problematikat e ndarjes së shoqërisë “OSHEE” sh.a., ku ndër të cilat më kryesoret që kanë lidhje me përcaktimin e tarifave janë:
  - Në zbatim të procesit të nisur të ndarjes së shoqërisë është e nevojshme të vijohet me ndryshime nënligjore duke iu referuar një modeli tregu i cili do të ishte optimal jo vetëm për shoqërinë “OSHEE” sh.a. por edhe për operatorët e tjerë të energjisë.
  - Nevojitet të përcaktohet operatori i energjive të rinovueshme jashtë shoqërisë “OSHEE” sh.a..
  - T’i jepet zgjidhje problematikës së akomodimit në treg të sasisë së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (RES), që rezulton përtej nevojave për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Në vijim të etapave të mësipërme, nevojitet përcaktimi i buxheteve për dy shoqëritë: “OSSH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a., gjë që do të mundësojë vlerësimin e të ardhurave të nevojshme për aktivitetet e rregulluara. Sa më sipër ERE me Vendimin e Bordit Nr.264, datë 20.12.2018, vendosi Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muaj, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a (O.S.SH sh.a); miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i

Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a) miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. Nr. 215, datë 11.10.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.1, përkatësisht:
    - data 31 Dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019
  2. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.2 aj, përkatësisht:
    - data 31 Dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019
  3. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.3, përkatësisht
    - data 31 Shtator 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019
  4. Ndryshimine afatit të përcaktuar në nenin 10 pika 10.2, përkatësisht:
    - data 1 Janar 2019 të ndryshohet me datën 1 Korrik 2019
  5. Kompania "OSHEE" sha, të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi :
    - "Përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara nga Rregullorja "Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike", brenda datës 1 Korrik 2019
  6. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë OSHEE sha lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.  
Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**